

Gjendja e kërkimeve në shkencat shoqërore në Universitetin e Prishtinës

Tryezë: Prill 2013

Më 5 tetor 2012, Qendra për Kurajo Politike (CPC), organizoi konferencën ndërkombëtare *Roli i shkencave shoqërore në shoqëritë në tranzicion, me theks të veçantë në Kosovë*. Konferenca u përkrah nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në kuadër të Programit për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (RRPP). Rreth 50 profesorë universitar, hulumtues nga vendi dhe ndërkombëtar, përfaqësues të shoqërisë civile kontribuan në identifikimin e problemeve dhe skicimin e një numri rekomandimesh për Universitetin e Prishtinës (UP), kolegjet private dhe organizatat hulumtuese në Kosovë. Në shkurt të vitit 2013, CPC publikoi një analizë me titull *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*.

Më 19 prill 2013, CPC organizoi një tryezë për të diskutuar hapat vijues që do të duhej të ndërmerreshin për implementimin e rekomandimeve të daluara nga analiza me titull *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*.¹ Në këtë tryezë u debatua lidhur me hapa konkret që janë ndërmarrë dhe pritet të ndërmerren për të avacuar kapacitet hulumtuese dhe për të shtuar motivimin dhe stimulimin e stafit akademik në UP.

Tri dokumente u shqyrtuan gjatë kësaj tryeze: *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë* (CPC); *Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016* (UP); dhe Raporti Informues mbi *Shkencat Sociale dhe Humanistike në Kosovë* (përgatitur për projektin WBC-INCO.NET).

Qëndrimet e shprehura në këtë raport janë përmbledhje e mendimeve të shumicës së pjesëmarrësve në tryezë dhe takime, dhe jo patjetër të institucioneve pjesëmarrëse në këtë tryezë.

¹ Më 5 prill 2013 CPC ka krijuar një grup punues i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rektorati i UP-ës, profesorë të Departamentit të Shkencës Politike, Departamentit të Sociologjisë, dhe Fakultetit Juridik, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Grupi punues do të marrë pjesë në tryezat e organizuara nga CPC dhe do të kontribuoj rreth hapave konkret që duhet ndërmarrë lidhur me temën e tryezës së mbajtur. Adem Beha, Ligjërues në Departamentin e Shkencave Politike është Kordinator i grupit.

Hulumtimi në shkencat shoqërore në UP

Në analizën e shkurtit të vitit 2012 Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë, ishte vërejtur se gjendja e hulumtimeve në UP nuk është premtuese. Ndër sfidat e përmendura, përkritazi me hulumtimin, analiza vëren pengesa si: mungesa e financimit, kapacitetet jo adekuate për hulumtim, qendra të pakta dhe jo funksionale për hulumtime, struktura jo efektive për menaxhimin e projekteve, koleksione të pamjaftueshme dhe të vjetëruara të librave dhe revistave në bibliotekat universitare, mungesa e lloj-llojshmërisë së kurseve, mungesa e kurseve dhe stafit adekuat mbi metodat hulumtuese shkencore, mungesa e studimeve dhe programeve MA dhe PhD.²

CPC përmbodhi nga konferenca ndërkombëtare *Roli i shkencave shoqërore në shoqëritë në tranzicion, me theks të veçantë në Kosovë* 12 rekomandime me qëllim të përmirësimit të gjendjes së hulumtimeve dhe të avancimit të studimeve në shkencat shoqërore e humanistike në UP.

Paralelisht trajtimin të rekomandimeve të analizës *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*, prof. Arben Hajrullahu adresoi disa dilema: “Së pari, sa jemi të përgatitur që të ndërlidhim programet e studimit me hulumtime, dhe së dyti, sa jemi duke krijuar progres apo regres në çështjen e ndërkombëtarizimit real të Universitetit të Prishtinës – jo vetëm në kuptimin e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale me universitetet perëndimore, por edhe implementimin e programeve dhe hulumtimeve të përbashkëta me këto universitete.”

Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016

Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016 (Strategjia), është një dokument serioz që përcakton objektiva dhe masa të qarta për avancimin e kërkimit shkencor në UP.³ Strategjia mbështetet në *Programin Kombëtar të Shkencës 2010–2015*⁴ e cila ka identifikuar katër objektiva: burimet njerëzore, infrastruktura, bashkëpunimi ndërkombëtar, lidhja e hulumtimit me ekonomisë dhe shoqërisë. Për më shumë, Strategjia ngërthen edhe planin e saj buxhetor dhe atë të veprimit. Sipas përlogaritjeve të bëra nga grupi i ekspertëve që kanë hartuar Strategjinë, buxheti i nevojshëm për implementimin e saj, ashtu siç thuhet në Strategji, është “1–3,5% e buxhetit vjetor të UP-së, pa i llogaritur të hyrat vetanake nga veprimtaria akademike dhe ekonomike”.⁵ Megjithatë, hendeuku mes 1 dhe 3.5% mbetet shumë i madh dhe ende mbetet e paqartë nëse shpenzimet buxhetore për implementimin e Strategjisë janë planifikuar mirë, në njërin anë dhe se cilët donatorë do të kontribuojnë në implementimin e saj, në anën tjetër.

Prorektori për kërkime shkencore i UP-së, prof. Avdullah Alija, prezantoi Strategjinë dhe theksoi përkushtimin e menaxhmentit aktual të UP-së për avancimin e kapaciteteve hulumtuese. “Së fundi ka përmirësime të dukshme në këtë drejtim. Ne kemi rritur aktivitetet tona që kanë të bëjnë me ndarjen e informatave dhe projekteve hulumtuese në Kosovë dhe rajon përmes përditësimeve të vazhdueshme në ueb-faqën e UP-së dhe kemi krijuar një ‘Grup Bërthamë’ për ofrimin e asistencës teknike për hartimin e projekteve kërkimore në Universitetin e Prishtinës”, theksoi Prorektori Alija.⁶

Edhe pse Strategjia rregullon një gamë të gjerë të fushave në sferën e kërkimeve shkencore, këtu do të prezantohen vetëm disa aspekte të Strategjisë që janë të lidhura me rekomandimet e analizës së CPC e që njëkohësisht janë të vendosura edhe si objektiva të vet Strategjisë.

Secila prej objektivave të Strategjisë parasheh masa konkrete për realizimin e rezultateve të pritshme. Disa prej masave që parasheh Strategjia janë: UP do të përkrahë zhvillimin e së paku 5 programeve të studimeve të doktoratës në disiplina të ndryshme dhe së paku 1 program ndërdisiplinor në programin e doktoratës; UP mbështet financiarisht së paku 20 mobilitete afatshkurtra në vit për hulumtuesit më aktiv të UP-së; Miratimi i rregullores për stimulim të personelit të përfshirë në punë kërkimore-shkencore/artistike; Themelimi i së paku 5 qendrave të ekselencës (institute kërkimore shkencore) në UP; Qasjet në së paku dy platforma elektronike; Krijimi i një ‘Grupi Bërthamë’ prej 5–7 personave që do të ofroj asistencë teknike për planifikimin e së paku 5 projekteve kërkimore në vit në UP; Ndarja e së paku 1% të buxhetit të përgjithshëm të UP-së për të përkrahur zbatimin e projekteve ndërkombëtare; Shpërndarja e informacioneve relevante për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes platformës elektronike të Univeritetit, etj.⁷

2 Shih Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë, http://www.rppp-westernbalkans.net/en/policy-dialogue/Kosovo/mainColumnParagraphs/00/text_files/file0/Policy_Brief_Albanian.pdf (qasur më 24 prill 2013)

3 Shih Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016 <http://www.uni-pr.edu/getattachment/4fc95f03-b53f-4e7c-a2a0c0056b9c43e4/Strategjia-per-veprimtari-kerkimore-shkencore-arti.aspx> (qasur më 23 prill 2013)

4 Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës 2010–2015, <http://www.uni-pr.edu/getattachment/21dfd45e-cd3e-47da-ad78-a2fe060ec1e9/Programi-Kombetar-i-Shkencës-i-Republikës-se-Kosov.aspx> (qasur më 22 prill 2013)

5 Shih Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016 <http://www.uni-pr.edu/getattachment/4fc95f03-b53f-4e7c-a2a0c0056b9c43e4/Strategjia-per-veprimtari-kerkimore-shkencore-arti.aspx> (qasur më 23 prill 2013)

6 ‘Grupi Bërthamë’ përbëhet nga: Prof. Dukagjin Pupovci, kryesues; Prof. Lule Ahmedi, anëtare; Prof. Qerim Qerimi, anëtar; Prof. Avni Hajdari, anëtar; Prof. But Dedaj, anëtar; Prof. Hysen Bytyqi, anëtar; Besnik Fetahu, anëtar. Shih <http://www.uni-pr.edu/Kerkime-Shkencore/Grupi-Berthame.aspx> (qasur më 22 prill 2013).

7 Shih Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016 <http://www.uni-pr.edu/getattachment/4fc95f03-b53f-4e7c-a2a0c0056b9c43e4/Strategjia-per-veprimtari-kerkimore-shkencore-arti.aspx> (qasur më 23 prill 2013)

Sfida dhe Veprime

Sfidat me të cilat ballafaqohet UP janë të shumta. Gjatë tryezës, pjesëmarrësit, profesorët dhe menaxhmenti i UP-së identifikuan disa prej sfidave dhe veprimeve si në vijim.

Sfidat:

1. Numër i vogël i projekteve hulumtuese për nevojat e shoqërisë kosovare;
2. Kapacitete të pamjaftueshme për absorbimin e fondeve ndërkombëtare në projektet hulumtuese;
3. Mungesa e e punës në grupe. Hulumtimi zhvillohet kryesisht mbi baza individuale;
4. UP është institucion relativisht i centralizuar dhe *Ligji për Arsimin e Lartë* nuk krijon hapësirë të mjaftueshme dhe nuk e rregullon autonominë financiare të njësisve akademike dhe instituteve brenda UP-së;⁸
5. Mungesa e funksionalizimit të instituteve ekzistuese brenda UP-së që do të duhej të merreshin me kërkime shkencore;
6. Mungesa e fleksibilitetit të UP-së kundrejt instituteve kërkimore-shkencore brenda vet UP-së;
7. Legjislacioni dhe kontratat e nënshkruara mes UP-së dhe stafit akademik nuk e rregullojnë në mënyrë kontraktuale punën kërkimore-shkencore të stafit akademik. Pjesa dërrmuese e stafit akademik shumicën e kohës e shpenzon në mësimdhënie;
8. UP ka miratuar *Strategjinë për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016*, por ende nuk ekziston një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të saj.

Veprimet:

Përkundër gjendjes jo shumë premtuese në kërkimet shkencore në UP, menaxhmenti aktual i UP-së ka ndërmarrë një numër veprimesh shpresëdhënëse. Për shembull, në mars të vitit 2013, UP ka krijuar me vendim të veçantë (nr. 646) një 'Grup Bërthamë' të përbërë nga shtatë anëtarë për ofrimin e asistencës teknike në hartimin e projekteve shkencore në UP. Krijimi i 'Grupit Bërthamë' është themeluar në përputhje me *Strategjinë për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016* të UP-së. Paralelisht kësaj, menaxhmenti aktual i UP-së ka ndërmarrë hapa konkret në bashkëpunim me menaxhmentet e reja të fakulteteve për të ri-funksionalizuar institutet ekzistuese kërkimore. Momentalisht ka pesë institute dhe një qendër për përsosshmëri në mësimdhënie. Ato janë: Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike; Instituti për Ekzaminimin e Materialeve; Instituti i Medias; Instituti për Kërkime Juridike; Instituti XMGJT (Xehetarisë, Metalurgjisë, Gjeologjisë dhe Teknologjisë); dhe Qendra për Përsosshmëri në Mësimdhënie.⁹ Së fundi, sipas prof. Avdullah Alija, Këshilli Drejtues i UP-së ka miratuar kërkesën për themelimin e tri

instituteve tjera të reja: dy në kuadër të Fakultetit për Shkencë Matematiko-Natyrore dhe një në kuadër të Fakultetit Ekonomik.¹⁰

Njëri nga problemet me të cilat ballafaqohet stafi akademik universitar i interesuar në kërkime vazhdon të mbetet mungesa e informatave. Megjithatë, shpërndarja e informatave prej UP-së rreth kërkimeve dhe projekteve kërkimore ka shënuar rritje gjatë muajve të fundit. Ueb-faqja e UP-së është përditësuar me informata të reja rreth legjislacionit, Strategjisë, *Planit Kombëtar të Shkencës* dhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me punën kërkimore. Po ashtu, UP-ja kohëve të fundit ka shpërndarë informata për projektet që janë fituar përmes TEMPUS apo donatorëve të tjerë dhe njëkohësisht ka përmbledh në mënyrë të shkruar aktivitetet e menaxhmentit aktual.

Rekomandimet

Të përgjithshme:

- Të zbatohet nga të gjitha palët në plotëni *Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016*;
- Të zbatohen nga të gjitha palët rekomandimet e nxjerra nga konferenca ndërkombëtare për *Roli i shkencave shoqërore në shoqëritë në tranzicion, me theks të veçantë në Kosovë*, përmbledhur në analizën *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*, botuar në shkurt të vitit 2013 nga CPC.

Të veçanta:

- Të krijohen mekanizma monitorues rreth zbatimit të Strategjisë për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013–2016, në të cilët mekanizma do të merrnin pjesë të gjitha palët relevante të interesit;
- UP të rifunksionalizoj dhe të jep përkrahje financiare në plotëni për institutet kërkimore brenda UP-së;
- Të avokohet nga UP dhe të gjitha palët tjera për amendamentimin e *Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë* që të garantohet autonomia financiare për institutet kërkimore brenda UP-së;
- UP të racionalizojë procedurat burokratike për shfrytëzimin e fondeve të instituteve kërkimore dhe të rris fleksibilitetin e UP-së kundrejt instituteve kërkimore;

⁸ Ligji Nr.04/L-037, Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Neni 13. Shih <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20e%20larte.pdf> (qasur më 21 maj 2013)

⁹ Shih <http://www.uni-pr.edu/Kerkime-Shkencore/Institutet-Qendrat-kerkimore.aspx> (qasur më 23 prill 2013)

¹⁰ Kjo informata është dërguar në formë të komentit gjatë hartimit të raportit nga prof. Avdullah Alija, Prorektor për Kërkime Shkencore në Universitetin e Prishtinës (qasur më 13 maj 2013).

- Menaxhmenti i UP-së të vazhdoj me fuqizimin dhe përkrahjen e 'Grupit Grupit Bërthamë' të UP-së;
- UP të miratoj rregulloren për stimulimin e personelit të përfshirë në punë kërkimore-shkencore/artistike, ashtu siç parashihet me Strategji;
- UP të garantoj mbështetje financiare për më së paku 20 mobilitete afatshkurtra në vit për hulumtuesit më aktivë, ashtu siç parashihet me Strategji;
- UP të zhvilloj së paku 5 programe të studimeve të doktoratës në disiplina të ndryshme dhe së paku 1 program ndërdisiplinor në programin e doktoratës, ashtu siç parashihet me Strategji;
- UP të ndaj së paku 1% të buxhetit të përgjithshëm të Universitetit për të përkrahur zbatimin e projekteve ndërkombëtare, ashtu siç parashihet me Strategji.